



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 189 Prot.

Tiranë, më 11 . 06 . 2020

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr 4 datë 11 . 06 . 2020

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 për “*Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, VKM nr.469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”,

VENDOSI:

1. Miratimi i botimit të lojës “**Mos u nxeh**” në 1000 kopje për çdo qytet (7 qytete x 1000 kopje/për qytet = 7000 kopje gjithsej), pjesë e projektit “E ka kush e ka”, hartuar nga Organizata Ndërkombëtare CHwB, sipas projektit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

PIRO MISHA

Anëtarë

Znj. Ada Ilia

Znj. Mira Hoxha

Znj. Anila Ferizaj

Znj. Floresha Dado



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN



Titulli i projektit:
Shumëfishimi i koleksionit
"Mos u nxeh"

Titulli i projektit:

Shumëfishimi i koleksionit “Mos u nxeh”
(Mësojmë për qytetet e Shqipërisë duke luajtur)

- 1. Përmbajtja**
- 2. Qëllimet dhe objektivat**
- 3. Metodologjia**
- 4. Aktivitetet kryesore**
- 5. Rezultatet kryesore**
- 6. Përfituesit**
- 7. Financimi**
- 8.Zona e zbatimit**
- 9. Grupi i punës**



1. Përmbajtja

Nga koleksionit më i madh “E ka kush e ka”, i cili është mbështetur nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit në kuadër të programit kombëtar “Bëjmë Detyrat e Shtëpisë”, Qendra e Botimeve për Diasporën ka përzgjedhur koleksionin “Mos u nxe”.

Koleksioni është krijuar i organizatës jofitimprurëse “Trashëgimia Kulturore pa Kufij”, e themeluar në Bosnjë dhe Hercegovinë në 1995, e shtrirë në Kosovë në 2001 dhe në Shqipëri në dhjetor 2006.

Ky koleksion synon, që nëpërmjet një serie libërthash dhe lojërash, të përfshijë fëmijë dhe të rritur në zbulimin dhe rizbulimin e trashëgimisë kulturore, si një urë lidhëse me botën që na rrethon.


Koleksioni përfshin lojën e famshme “Mos u nxe”, e cila luhet duke mësuar rrugët dhe vendet më të njohura të qyteteve kryesore të Shqipërisë. Koleksioni është menduar të shumëfishohet në 1000 kopje për çdo qytet (7 qytete x 1000 kopje/për qytet = 7000 kopje gjithsej)

1. “Mos u nxe”- Gjirokastrë;
2. “Mos u nxe”-Tiranë;
3. “Mos u nxe”- Berat;
4. “Mos u nxe”- Shkodër;
5. “Mos u nxe”- Korçë;
6. “Mos u nxe”- Durrësi;
7. “Mos u nxe”- Elbasan.

Trashëgimia kulturore nuk është thjesht një njohuri që duhet mësuar, por një mbështetje edukative dhe argëtuese në shërbim të njohjes dhe zbulimit të së resë dhe të shoqërisë sonë.

Koleksioni shërben dhe si mbështetje praktike për aktivitetet argëtuese përfshirëse për fëmijë e të rritur, të organizuara së bashku me institucione arsimore, muze dhe site të ndryshme në Shqipëri.

Koleksioni “Mos u nxe” është shpallur në vitin 2018 fitues i konkursit “Historitë Evropiane të Trashëgimisë”, organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian.



2. Qëllimet dhe objektivat

Synimi ynë është botimi i 7 lojërave me qytetet përkatëse.

Nëpërmjet lojës dhe argëtimit fëmijët në Diasporë do të marrin njohuri mbi qytetet kryesore të Shqipërisë dhe mbi gjuhën shqipe.

Kjo lojë është e vlefshme për fëmijët dhe të rriturit në Diasporë, me njohuri të pakta apo të mjaftueshme në gjuhën shqipe.

Kultivon ndjenjën e krenarisë për identitetin kombëtar shqiptar në Diasporë, duke i njohur ata me pasurinë tonë trashëgimore.

3. Metodologjia

Për realizimin e këtij projektpropozimi, si hap i parë do të jetë marrja e të drejtave të autorit nga organizata e cila i gëzon këto të drejta: Cultural Heritage without Borders (CHwB). Materialet janë përgatitur nga znj. Anisa Mano, kompozimi i lojës është realizuar nga Anisa Mano dhe Ana Pekmezi; ilustrimet nga Ledia Kostandini.

Për marrjen e këtyre të drejtave do të nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi midis Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Shoqatës Cultural Heritage without Borders (CHwB). Nëpërmjet këtij memorandum, të drejtat e botimit të këtij koleksioni do të jepen falas.

Në përfundim, nga QBD-ja do të realizohet botimi dhe printimi i koleksionit me lojën “Mos u nxeh” me 7 qytete të Shqipërisë.



Rezultatet kryesore

Njohja e qyteteve shqiptare.

Shtimi i dashurisë për vendlindjen dhe tokën e të parëve.

Kultivimi i vlerave të vetëdijes kombëtare dhe të kulturës amtare.

Ruajtja e gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, si shprehje e kulturës, por edhe e atdhedashurisë.

Promovimi i trashëgimisë kulturore përmes lojës dhe argëtimit.



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

PËRFITUESIT

Fëmijë, të rritur dhe pjesëtarë të komunitetit shqiptar të Diasporës.

FINANCIMI

Buxheti i shtetit

ZONA E ZBATIMIT

Në Shqipëri dhe në Diasporë

GRUPI I PUNËS

Cultural Heritage without Borders (CHWB). Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes



Dr. [Signature] [Signature] [Signature] [Signature]